

Mbi Auditimin e Ushtuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Tiranë

Raporti përfundimtar i auditimit të ushtuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Tiranë “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së DPD me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi” për periudhën viti 2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 136, datë 30.09.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015, është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet” dhe me shkresën nr. 510/26, datë 30.09.2015 për Agjencinë e Prokurimit Publik, është dërguar pjesë nga Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për marrjen e masave administrative.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën 433/12, datë 02.09.2014 i ka dërguar DPD Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe masat për përmirësimin e gjendjes, ku janë rekomanduar 14 masa organizative, 1 masë shpërblim dëmi, ndërsa masat disiplinore janë lënë në kompetencë të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Nga auditimi i tyre rezulton se nga 14 masat organizative të rekomanduara janë zbatuar pesë masa (4, 5, 9, 11 dhe 13), janë në proces dy masa (1 dhe 10) dhe janë pa zbatuar 7 masa (2, 3, 5, 6, 7, 12, dhe 14) dhe masa e rekomanduar për zhdëmtim dhe masat disiplinore janë zbatuar.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 18-34 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të analizojë dhe marrë masa për zbatimin detyrave të rekomanduara dhe të parealizuara të lëna në auditimin e mëparshëm si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e tyre.

Menjëherë

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për vitin 2014 është organizuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1049, datë 04.12.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 205, datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar”, dhe ka 1002 punonjës në administratën e saj. Në drejtim të plotësimit të strukturës organike u konstatuan mangësi dhe mospërputhje me kuadrin ligjor e konkretisht:

-Nga administrata doganore janë likuiduar sipas vendimeve të gjykatës deri në kthimin në vendin e punës tetë punonjës të larguar në vite, të cilët janë paguar mesatarisht me pagën vjetore prej rreth 2.908.720 lekë si dhe në total për të gjithë vitet në vlerën 29,440,310 lekë, shumë e cila rritet nga viti në vit, duke i shkaktuar dëm buxhetit të shtetit në këtë vlerë sepse për të njëjtin vend pune janë paguar dy punonjës;

-Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për vitin 2014 rezulton të jenë lëvizur 534 punonjës ose rreth 53 % e tyre ose gjysma e administratës;

-Në fund të vitit 2014, numri i vendeve bosh në administratën doganore ishte gjithsej 35 vende, ku 10 vende janë në administratën qendrore dhe 25 vende në degët doganore, të cilat duhet të ishin plotësuar me punonjës sipas legjislacionit në fuqi;

-Nuk janë kryer procedurat për 123 punonjës të administratës doganore në konfirmimin ose jo të Statusit të Nëpunësit Civil, duke marrë vendimet përkatëse për çdo njërin prej tyre në periudhe prove kjo dhe në bazë të shkresës nr. 8537, datë 07.04.2015 të Departamentit të Administratës Publike.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 46-70 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të analizojë rastet e mësipërme dhe marrë masa konkrete duke nxjerrë përgjegjësitë për to: plotësimin e 35 vendeve bosh në administratën doganore; sistemimin në punë të tetë punonjësve sipas vendimeve të gjykatës që i kushtojnë mesatarisht buxhetit të shtetit rreth 2,908,720 lekë në vit; transferimi i punonjësve të kryhet sipas procedurave të parashikuara në legjislacion; kryerjes së procedurave për 123 punonjës të administratës doganore në konfirmimin ose jo të Statusit të Nëpunësit Civil, duke marrë vendimet përkatëse për çdo njërin prej tyre në periudhë prove kjo dhe në bazë të shkresës nr. 8537, datë 07.04.2015 të Departamentit të Administratës Publike.

Menjëherë

3. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk respektohen të drejtat e punonjësve si punëdhënës në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshime, e konkretisht nenet 83, 84, 85, 86,87, 88, 89, 90, 91 e vijues 203 që përcaktojnë kohëzgjatjen e kohës së punës, ku punonjësi duhet të punojë 40 orë në javë e në rast se ai punon dhe ditët e pushimit, duhet të paguhet me pagë shtesë. Mosrespektimi i këtyre kërkesave ka sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit në një vlerë prej rreth **35,815,163 lekë** (4,374,000 lekë shpenzime gjyqësore + 31,441,163 lekë paga shtesë), detyrime të kërkuar në rrugë gjyqësore ku duhet të theksohet se vlera prej 4,374,000 lekë e shpenzimeve gjyqësore rëndon direkt buxhetin e shtetit.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 46-70 të Raportit Përfundimtar te Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa në zbatim të ligjit për respektimin e të drejtave të punonjësve të administratës së saj në lidhje me kohëzgjatjen e kohës së punës. Në rastet e punës përtej orarit dhe në ditët e pushimit punonjësit duhet të paguhet me pagë shtesë në përputhje me kohëzgjatjen mbi orarin e punës, sepse mospagimi i tyre mund të jetë me pasoja në buxhetin e shtetit si rezultat i rëndimit të tij me shpenzime gjyqësore të fituara nga punonjësit e administratës doganore.

Menjëherë

4. Nga auditimi i zbatimit të Manualit për MFK, pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik” në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave u konstatua që jo në të gjitha rastet vendimet e grupit janë marrë në mënyrë kolegjiale dhe nuk janë pasqyruar në dokumente dhe vënë në dispozicion menaxhimit të njësisë.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 46-70 të Raportit Përfundimtar te Auditimit, është rekomanduar:

DPD të dokumentojë vendimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, në zbatim të Manualin për MFK, pika 4.2.9, si dhe të merren masa që të kryhen trajnime të stafit mbi njohjen dhe procesin e implementimit të MFK-së.

Në vazhdimësi

5. Nga auditimi mbi kryerjen e detyrave funksionale të Drejtorisë së Kontrollit në Departamentin e Akcizës u vu re se në disa raste, kur ishin konstatuar diferenca produkti të pa hedhura për konsum, ishte evidentuar vetëm detyrimi për Akcizën, pa evidentuar TVSH-në respektive prej **9,232,235 lekë** dhe pa njoftuar për këtë Drejtorinë Rajonale të Tatimeve si dhe DPT-në.

Sa më sipër trajtuar në faqet 141-149 të Raportit Përfundimtar te Auditimit, është rekomanduar:

Nga Drejtoria e Kontrollit në Departamentin e Akcizës, si për rastet e evidentuara në tabelën 9.7, ashtu si dhe në vijim, kur konstatohet diferenca në sasi të produkteve të pa hedhura për konsum, të njoftojë përveç Degës Doganore përkatëse edhe Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në mënyrë që të sigurohet edhe mbledhja e TVSH-së.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Në fokus të këtij auditimi ka qenë raportimi i të dhënave në lidhje me realizimin e të ardhurave nga administrata doganore në përmbushje të misionit të saj kryesor, kjo për shkak të certifikimit të shifrave që përfshihen në Raportin e zbatimit të buxhetit vjetor nga KLSH. Nga të dhënat e siguruar nga Sektori i Statistikës, Analizës dhe Raportimit rezulton se janë realizuar të ardhura 150,640 milion lekë nga 156,224 milion lekë të programuar sipas Ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, ndërkohë konstatohet se në raportin e Ministrisë së Financave të ardhurat faktike të grumbulluara janë 150,394 milion lekë.

Sa më sipër, trajtuar në faqen 102-107 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Sektori i Statistikave në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe të Financës në DPD, të rakordojnë me Ministrinë e Financave për sa i përket klasifikimit të treguesve të të ardhurave dhe shifrave të raportuara. Raportimi për treguesit e realizimit të planit të të ardhurave të bëhet mbi të njëjtat vlerësime dhe klasifikime.

Në vazhdimësi

7. Nga auditimi i Borxhit Doganor u konstatua se ai është rritur me 3,969 milion lekë duke arritur në vlerën 12,830 milion lekë, fenomen që është shoqëruar njëkohësisht me një mbulim më të vogël me urdhra ekzekutimi, nga 54% në 42% që ishte në vitin 2013. Gjithashtu u konstatua se mungon bashkëpunimi me të gjitha strukturat doganore dhe me strukturat e specializuara të shtetit që merren me administrimin dokumentar dhe fizik të aktiviteteve ekonomike – tregtare.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 107-115 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave të rrisë bashkëpunimin me të gjitha strukturat doganore dhe me strukturat e specializuara të shtetit që merren me administrimin dokumentar dhe fizik të aktiviteteve ekonomike - tregtare të vendit, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të përbashkëta dhe aplikimit të tyre kryesisht; me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit, me Sistemin Bankar të Nivelit të Dytë, me Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive, si dhe me Zyrat e Përmbartimit Gjyqësor duke përcaktuar saktë dhe detyrimet e ndërsjella për mbledhjen e borxhit doganor.

Vazhdimisht

8. Në tenderin e zhvilluar me objekt, “*Blerje Bicikleta*”, ish-zv. Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, ka urdhëruar kryerjen e prokurimit, në kushte kur nuk ka kërkesë me shkrim apo format elektronik nga sektor, degë, apo drejtori për këtë mall. Për shpenzime të pa justifikuar ligjërisht dhe pa efektivitet në raport me rezultatet përfundimtare dhe objektivat e vendosura, nuk rezulton të ketë dokument apo shkresë në formën e një kërkesë nga asnjë departament/drejtori, apo pikë doganore lidhur me nevojën për këtë lloj malli, për të cilin është nxjerrë urdhri i prokurimit nga ana e titullarit të autoritetit kontraktor. Ky lloj produkti nuk mund të shërbejë në asnjë nga departamentet, drejtoritë apo degët doganore, pasi nuk lidhet drejtpërdrejt dhe nuk gjen zbatim me rregullat dhe detyrat funksionale të tyre, prokurim me vlerën **2,310,012 lekë**.

Ky produkt i prokuruar nuk i shërbeu asnjëherë qëllimit të tij dhe në datën 11 Qershor 2015 ka kaluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke vërtetuar mungesën e efektivitetit, eficiencës dhe

ekonomicitetit të tij, ndërkohë që kjo para publike mund të ishte përdorur në nevoja më të rëndësishme që ka DPD.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 70-102 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të evidentojë këtë problematikë në këndvështrimin e eficiencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit dhe të marra masa që raste të tilla të mos i përsërisë në të ardhmen.

Menjëherë

9. Në objektin “Rikonstruksioni i pjesshëm i godinës së Degës Doganore, Fier”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultoi se investimi në këtë godinë, në kushtet që administrata nuk operon në të, por në ambiente të tjera, tregon përdorim të gabuar të fondeve dhe vlerë të humbur të parasë publike.

Gjithashtu punimet e kryera ishin të një cilësie jo të mirë, suvatimi dhe patinimi ishin jo të rregullta dhe uniforme, parketi rezultoi me deformime dhe muret me lagështi të theksuar deri në rënien e suvatimit, në mos përputhje me kontratën e sipërmarrjes dhe specifikimet teknike përkatëse.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 70-102 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të ngrihet një grup pune që të vlerësojë efektivitetin e këtij investimi dhe nëse ky investim nuk vihet në shfrytëzim, të nxirren efektet financiare të dëmit të shkaktuar dhe përgjegjësit të rikuperojnë vlerën e tij.

Gjithashtu të merren masa për riparimin e të gjitha punimeve të konstatuara me mangësi në cilësi, në objektin “Rikonstruksioni i pjesshëm i godinës së Degës Doganore Fier” sipas specifikimeve teknike dhe kontratës për punë publike nr. 27497/11 prot, datë 16.12.2014 nga ana e sipërmarrësit të punimeve.

Brenda vitit 2015

10. Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Procedurave në lidhje me lëshimin e autorizimeve të regjimit të përpunimit aktiv dhe lejimit të përkohshëm janë mbajtur gjithsej 112 procesverbale për shkelje të legjislacionit doganor të pa dorëzuara pranë autoritetit doganor për të dalë me vendim administrativ, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 287.1 të Kodit Doganor dhe pikës 2; 3 dhe 4 të Udhëzimit nr. 6, datë 23.07.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor....”.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 115-119 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të marrë masat për eliminimin e këtij fenomeni, duke ndjekur gjithë procedurat e nevojshme për delegimin e procesverbaleve për shkeljet doganore pranë autoriteteve doganore kompetente.

Menjëherë

11. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Kontabilitetit (Drejtoria e Financës) dhe Sektori i Investimeve dhe Logjistikës, në lidhje me administrimin e vlerave materiale lidhur me shpenzimet për karburantin u konstatua se sasia e karburantit e tërhequr dhe e kontabilizuar në financë sipas kartelave të punonjësve është më e madhe dhe nuk përputhet analitikisht me sasitë e urdhëruara nga sektori i logjistikës; është urdhëruar dhe shpërndarë karburant nga sektori i logjistikës për makina private; i njëjti mjet me shërbim për një periudhë të caktuar në një vend të caktuar, figuron në një vend tjetër po atë datë duke përllogaritur konsum karburanti për të

dy rastet; është urdhëruar dhe shpërndarë karburant nga sektori i logjistikës pa urdhër shërbimi “Kërkesë për lëvizje automjeti jashtë rrethit” si dhe nga përlllogaritjet e itinerarit të përcaktuar në urdhrat e shërbimit, konsumi i karburantit rezulton shumë më tepër se normativa e konsumit për 100 km të mjetit, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 9.4 dhe 13.3 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe nenit 2; 3; 4 dhe 5 të Rregullores së Brendshme nr. 14443/1 prot, datë 12.09.2012 “Për përdorimin e automjeteve të sistemit doganor”.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 149-159 të RPA, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të marrë masat duke ndjekur gjithë procedurat e nevojshme për auditimin e problematikës së sipërcituar me qëllim nxjerrjen e dëmit të shkaktuar si dhe përgjegjësitë lidhur me personat shkaktarë të dëmit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin e Përfundimtar të Auditimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit në vlerën **152,405,100 lekë**; në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Kurs online për përmirësimin e gjuhës angleze”, ish zv. Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, ka urdhëruar për kryerjen e blerjeve të vogla, në kushte kur nuk ka kërkesë me shkrim apo në format elektronik nga sektor, degë, apo drejtori që të justifikojë nevojat për këtë shërbim. Për shpenzime të pa justifikuar ligjërisht dhe pa efektivitet në raport me objektivat e vendosura, duke përdorur fondet buxhetore për përmirësimin e gjuhës së huaj apo kualifikime të cilat duhet të përballohen nga vetë përfituesit pasi lidhen drejtpërdrejt me nivelin arsimor personal, veprime të cilat për pasojë kanë shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën 468,000 lekë, këto veprime bien në kundërshtim me kreun VI pika 2 shkronja (a), (b) të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, dhe kreun II, neni 8 pika 1, neni 15 të ligj nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 34-46 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **për arkëtimin e shumës prej 468,000 lekë** nga ish- zv. Drejtor i Përgjithshëm [REDAKTUAR], e cila ka urdhëruar kryerjen e këtij shërbimi ose nga të gjithë personat përfitues të këtij kursi.

Menjëherë

2. Në tenderin e zhvilluar me objekt, “Rikonstruksioni i godinës së Degës së Doganës Fier”, në preventivin e paraqitur nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] janë përfshirë pajisjet me TVSH në vlerën 126,972 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik, këto veprime vijnë në kundërshtim UKM nr. 2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pra nuk është ndarë veças vlера e “montimit” dhe veças vlера pajisjeve.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 70-102 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **për arkëtimin e shumës prej 126,972 lekë** nga operatori ekonomik [REDAKTUAR].

Menjëherë

3. Në tenderin e zhvilluar me objekt, “*Blerje Biçikleta*”, rezulton se janë vetëm 12 copë vend parkime biçikletash nga 30 që duhet të ishin, me një diferencë prej 18 copë më pak në vlerën prej 216,000 lekë, e cila përbën dëm ekonomik, veprime këto në kundërshtim me VKN “*Për rregullat e prokurimin publik*”, dhe nenin 4, pikat 1, 2 të kontratës nr. 26352/4 prot, datë 03.12.2014.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 70-102 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimin e shumës prej 216,000 lekë** nga [REDAKTUAR] në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim.

Menjëherë

4. Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Riparimi i skanerit Mobil THSCAN me rreze X*”, komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar ofertën jo në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, pasi në të është shtuar zëri 12: Mirëmbajtje vjetore, duke ju referuar preventivit vjetor të planit të mirëmbajtjes, duke përfshirë dhe taksën e udhëtimit për dy inxhinierë në 10 ditë, në vlerën 2,605,820 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik, veprime këto në kundërshtim me kreun V, nenin 53, pikat 1, pika 5 germa c të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 70-102 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimin e shumës prej 2,605,820 lekë** nga [REDAKTUAR] në cilësinë e kryetarit të KVO.

Menjëherë

5. Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje e pajisjeve të kontrollit, skanera*”, grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit, parashikon kryerjen e këtij shërbimi dy herë në vit, brenda vitit 2014, ndërkohë që kontrata lidhet më datë 15.08.2014 dhe përfundon më 31.12.2014, që do të thotë që ky shërbim do të kryhet vetëm për periudhën e mbetur të vitit 2014 përafërsisht 4 muaj, ndërkohë që fondi i vënë në dispozicion parashikon shërbim një vjeçar. Për pasojë nuk është mbuluar i gjithë viti 2014 me shërbim dhe është shkaktuar dëmi ekonomik në vlerën 1,056,084 lekë, veprime në kundërshtim me Kreun III, neni 23, pika 4 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” dhe Kreun III, pika 3 shkronja c e VKN nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimin publik*”.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 70-102 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimin e shumës prej 1,056,084 lekë** nga grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit [REDAKTUAR]

Menjëherë

6. Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje e pajisjeve të lëndëve radioaktive*”, grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit, parashikon kryerjen e këtij shërbimi 2 herë në vit brenda vitit 2014, ndërkohë që kontrata lidhet më datë 15.08.2014 dhe përfundon më 31 dhjetor 2014, që do të thotë që ky shërbim do të kryhet vetëm për periudhën e mbetur të vitit 2014 përafërsisht 4 muaj, ndërkohë që fondi i vënë në dispozicion parashikon shërbim një vjeçar. Për pasojë nuk është mbuluar i gjithë viti 2014 me shërbim dhe është shkaktuar dëmi ekonomik në vlerën

581,400 lekë, veprime këto në kundërshtim me Kreun III, neni 23, pika 4 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe Kreun III, pika 3 shkronja c e VKN nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimin publik”.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 70-102 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimin e shumës prej 581,400 lekë** nga grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit: [REDACTED].

Menjëherë

7. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Origjinës për administrimin e korrespondencës me Doganat Homologe të verifikimit të provave të origjinës rezultoi se për një periudhë 10 (dhjetë) mujore nga data e kërkesës për verifikimin e dëshmime të origjinës, nga doganat homologe nuk ka ardhur përgjigje. Nga sektori i origjinës për këto praktika, nuk është përgatitur dokumentacioni për refuzimin e trajtimit preferencial, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 33.6 të ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006, të MSA të RSH dhe KE, hyrë në fuqi më 01.04.2009; protokoli 4 lidhur me “Verifikimi i dëshmime të origjinës”.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 115-119 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin **për shpërblimin e dëmit për 4 subjekte, në vlerën 1,785,773 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 7.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

8. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Antikontrabandës lidhur me kryerjen e detyrave funksionale rezultoi se nuk janë dorëzuar procesverbale konstatimi për shkelje në fushën doganore pranë autoriteteve doganore kompetente si dhe nuk janë përcaktuar dhe zbatuar saktë dispozitat ligjore lidhur me penalitetet për shkeljet e konstatuara, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 261.1, 28.1, 285.4, 287.1/2 dhe 289.1 të Kodit Doganor.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 119-141 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin **për shpërblimin e dëmit për 15 raste, në vlerën 5,496,176 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 8.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.10.2015

9. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Hetimit lidhur me kryerjen e detyrave funksionale rezultoi se në përcaktimin e masës së penaliteteve nuk është marrë parasysh fakti se subjektet kanë qenë përsëritës në shkeljet doganore si dhe nuk ka patur bashkëpunim me Drejtorinë e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, si strukturë brenda të të njëjtit Departament për shkëmbim informacioni lidhur me subjektet të penalizuar për shkelje të legjislacionit doganor, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 287.2 të Kodit Doganor si dhe jo në përputhje me kërkesat e Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me nr. 10168 prot, datë 07.06.2011.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 119-141 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin **për shpërblimin e dëmit për 3 raste, në vlerën 4,642,951 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 8.2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.10.2015

10. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit të Pas Zhdoganimit lidhur me kryerjen e detyrave funksionale rezultoi se: nuk janë kryer detyrat referuar kërkesave të Program Kontrollit me pasojë mos llogaritje të detyrimeve doganore dhe interesit kompesues; për subjekte përsëritës në shkelje doganore është marrë minimumi i penaltetit; keq klasifikim i shkeljes nga autoriteti doganor kompetent me pasojë uljen e detyrimeve doganore si dhe për shkeljen e konstatuar nuk është mbajtur procesverbal konstatimi, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 261.2; 287.2;112; 142.1; 285.3 dhe 229.3 të Kodit Doganor si dhe nenit 287.1/3; 289.1; 293 dhe 295 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, për **14 subjekte me vlerë 133,225,875** (njëqind e tridhjetë e tre milion e dyqind e njëzet e pesë mijë e tetë qind e shtatë dhjetë e pesë) **lekë**, ku vetëm në subjektin “”, në **Degën Doganore Berat, u konstatuan shkelje të rënda në shumën 127,356,379** (njëqind e njëzet e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) **lekë**.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 119-141 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin **për shpërblimin e dëmit për 14 raste, në vlerën 133,225,875** (njëqind e tridhjetë e tre milion e dyqind e njëzet e pesë mijë e tetë qind e shtatë dhjetë e pesë) **lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 8.3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.10.2015

11. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Vlerës, Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore për unifikimin e metodologjisë së vlerësimit doganor të mallrave rezultoi se nuk janë kryer detyrat funksionale lidhur me praktikën doganore ku artikujt e importuar nga NEU (Kina) janë trajtuar me transaksion si dhe praktika doganore me deklaratë faturë vlera e të cilave është mbi 6000 €, trajtuar me MSABE, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 33-37 të Kodit Doganor; Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore*”; nenit 22 të Ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006, të M.S.A të R.SH dhe K.E, hyrë në fuqi më 01.04.2009; protokoli 4 lidhur me Përkufizimin e Konceptit të “Produkteve të Origjinës”, si dhe nenit 71.4 të Rregullores së Brendshme të D.P.D nr. 10168 prot, datë 07.06.2011 “*Detyrat funksionale të Drejtorisë së Vlerës*”.

Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 149-159 të Raportit Përfundimtar i Auditimit, është rekomanduar:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin **për shpërblimin e dëmit për 16 raste, në vlerën 2,200,049 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 10.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtores së Përgjithshme të Doganave të fillojë procedurat për të kaluar në Komisionin Disiplinor, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 për shkeljet e konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

I. Neni 58 gërma “c”, “largim nga shërbimi civil” për 5 (pese) nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë doganier regjime/përrjashtime në Degën e Doganës Berat, për veprimet jo në përputhje me nenin 15 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore në përmbushje të detyrave funksionale si dhe veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 112; 142.1 të KD si dhe nenit 287.1/3; 289.1 dhe 293 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, ku borxhi doganor përcaktohet në bazë të elementëve përkatës të taksimit për mallrat e importit, në datën e pranimi të deklarats për vendosjen e këtyre mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv në total për shumën 127,356,379 lekë.
2. Për [REDAKTUAR] me detyrë doganier i kontrollit fizik në Degën e Doganës Berat, për veprimet jo në përputhje me nenin 13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore në përmbushje të detyrave funksionale si dhe veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 112; 142.1 të KD si dhe nenit 287.1/3; 289.1 dhe 293 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, ku borxhi doganor përcaktohet në bazë të elementëve përkatës të taksimit për mallrat e importit, në datën e pranimi të deklarats për vendosjen e këtyre mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv në total për shumën 127,356,379 lekë.
3. Për [REDAKTUAR] me detyrë Kryetar i Degës së Doganës Berat, për veprimet jo në përputhje me nenin 13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore në përmbushje të detyrave funksionale në total për 3 (tre) raste.
4. Për [REDAKTUAR] me detyrë ish-Kryetar i Degës së Doganës Tiranë, aktualisht drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale, për veprimet jo në përputhje me nenin 13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore në përmbushje të detyrave funksionale në lidhje me marrjen e vendimeve administrative jo në përputhje me legjislacionin doganor, në total për 6 (gjashtë) raste.
5. Për [REDAKTUAR] me detyrë ish-jurist i Degës së Doganës Tiranë, aktualisht jurist i Degës Doganore Fier, për veprimet jo në përputhje me nenin 14.5 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore në përmbushje të detyrave funksionale në lidhje me konceptimin e vendimeve administrative jo në përputhje me legjislacionin doganor, në total për 4 (katër) raste.

II. Neni 58 gërma “b”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për 3 (tre) nëpunësit civil si më poshtë:

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë Kryetar i Degës së Doganës Korçë, për veprimet jo në përputhje me nenin 13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore në përmbushje të detyrave funksionale në lidhje me marrjen e vendimeve administrative jo në përputhje me legjislacionin doganor, në total për 6 (gjashtë) raste.
2. Për [REDAKTUAR] me detyrë ish Kryetar i Degës së Doganës Durrës, për veprimet jo në përputhje me nenin 13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore në përmbushje të detyrave funksionale në lidhje me marrjen e vendimeve administrative jo në përputhje me legjislacionin doganor, në total për 8 (tetë) raste.
3. Për [REDAKTUAR] me detyrë juriste e Degës së Doganës Korçë, për veprimet jo në përputhje me nenin 14.5 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore në përmbushje të detyrave funksionale

në lidhje me konceptimin e vendimeve administrative jo në përputhje me legjislacionin doganor, në total për 5 (pesë) raste.

C.2 Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet përkatës dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë titullarit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **duke vendosur gjobë për 10 (dhjete) personat** si më poshtë:

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë ish Zv. Drejtor i Përgjithshëm, DPD, Tiranë, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave;
2. Për [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të grupit për marrjen në dorëzim të mallit dhe anëtar i grupit të punës për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit;
3. Për [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit ofertave;
4. Për [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit ofertave;
5. Për [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave;
6. Për [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit ofertave;
7. Për [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit ofertave;
8. Për [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit ofertave;
9. Për [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të grupit për marrjen në dorëzim të mallit;
10. Për [REDAKTUAR] me detyrë magazinier.

Shënim: Për punonjësit e tjere për mangësi në zbatimin e detyrave funksionale, në raste të veçanta dhe për arsye se kanë shkëputur marrëdhëniet me institucionin, nuk rekomandohet masë disiplinore.

D. KALLZIM PENAL

I. Nga auditimi i kryer në DPD për Drejtorinë e Kontrollit pas Zhdoganimit, u konstatuan të meta e mangësi në zbatimin e legjislacionit doganor, procedurave të zhdoganimit, mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike si dhe nxjerrjes së vendimeve administrative, të cilat kanë sjellë si pasojë dëm ekonomik (detyrim doganor i munguar) në Buxhetin e Shtetit **në shumën 127.4 milion lekë**, (rreth 1 milion dollarë), të konstatuara në Degën Doganore Berat.

Mbi bazën e këtyre konstatimeve, KLSH, me shkresën Nr. 510/31 datë 04.12.2015 ka depozituar pranë organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat kallëzimin penal për E.P. ish-Kryetar dhe dy doganierë A.H. dhe Dh.XH. të Degës Doganore Berat, si dhe për tre specialistë F.O., R.K. dhe E.P. në sektorin e kontrollit të regjimeve doganore në DPD, me akuzën e “Shpërdorimit të detyrës”.

Nga auditimi u konstatua se subjekti “C.SH”, që operon nën Regjimin e Përpunimit Aktiv (RPA), i autorizuar për prodhimin e çantave të letres dhe të plastikës, nën këtë regjim ka rieksportuar çanta letre Exp 3 – procedurë 3151, ku kanë rezultuar mbetje teknologjike të cilat i janë zhdoganuar me Imp 9 – procedurë 9351, ndërsa nën këtë autorizim me Deklaratat Doganore IMP 4 (Hedhja e mallrave në qakullim të lirë), subjekti ka zhdoganuar me procedurë 4051, 1- “çanta letre, lidhëse, kuti kartoni dhe përforcues kartoni”, me një vlerë totale 49,961 euro, ndërkohë që në hyrje artikujt janë pranuar nga autoriteti doganor Berat me vlerë më të lartë. Nga ana e autoritetit doganor janë pranuar vlerat e mësipërme si dhe është përpunuar DAV-i pa qenë fizikisht malli në doganë në sasinë

me peshë 1,608,660 kg, ndonëse ky subjekt operon në RPA, dhe në DAV-et IMP5 me procedurë 5100 të Autorizimit të RPA. Po ashtu, nga ana e autoritetit doganor nuk është llogaritur interesi kompensues i detyrimit doganor.

Duke u ndodhur në kushtet e neneve 112; 141;142;143/ii, të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 287; 289; 293; 295;296; 299/3, të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, autoriteti doganor duhet të aplikonte vlerat: çanta letre me çmim 647.97 lek/kg; lidhëse me çmim 140.32 lek/kg; kuti kartoni me çmim 122.09 lek/kg dhe përforcues kartoni me çmim 76.79 lek/kg.

Efekti financiar me pasojë dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit është njëqind e njëzet e shtatë milionë e treqind e pesëdhjetë e gjashtëmijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë lekë, (detyrim doganor i munguar, plus interesi kompensues).

II. INDICIE PËR HETIME TË MËTEJSHME PENALE

Nga auditimi në fushën e prokurimeve në DPD, u konstatuan të meta dhe mangësi, konkretisht në tenderat “Blerje Uniforma Doganore”, “Blerje Biçikletash” si dhe “Riparim i skanerit Mobil THSCAN me rreze X”. Mbi bazën e këtyre konstatimeve KLSH me shkresën dhe numër 510/30 dhe datë 04.12.2015 ka depozituar pranë organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë indicie (të dhëna) për hetime të mëtejshme penale për ish-zv. Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për veprën penale të “**Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike**”.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatuan të meta dhe mangësi në shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik, e kryesisht në tenderat me objekt:

-Në tenderin me objekt “*Blerje Uniforma Doganore*” është kërkuar dhe përzgjedhur procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në kushtet kur nuk ka një ngjarje të paparashikueshme nga ana e Autoritetit Kontraktor, si dhe duke mos qenë në kushtet e emergjencës. Duke ju referuar rregullave të prokurimit publik, neni 32 pika 2/c të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ky rast nuk përmbush asnjë nga kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure, të përcaktuara në dispozitat ligjore për prokurimin publik.

-Në tenderin me objekt, “*Blerje Biçikleta*”, Urdhri i brendshëm për ngritjen dhe përbërjen e KVO, është firmosur nga i njëjti person, në këtë rast ish-zv Drejtor i Përgjithshëm, që në cilësinë e kryetarit të autoritetit kontraktor në mungesë, ka urdhëruar veten për të qenë kryetar i KVO, pra njëherazi dy funksione, veprime këto në kundërshtim me kreun VI, pika 1 shkronja a të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”. Ish-zv. Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, ka urdhëruar kryerjen e prokurimit, në kushtet kur shpenzimet janë të pa justifikuara ligjërisht dhe pa efektivitet në raport me rezultatet përfundimtare dhe objektivat e vendosura. Ky lloj produkti nuk mund të shërbejë në asnjë nga departamentet, drejtori apo degë doganore, pasi nuk lidhet drejtpërdrejt dhe nuk gjen zbatim me rregullat e detyrat funksionale të tyre. Ky produkt i prokuruar nuk i shërbeu asnjëherë qëllimit të tij dhe aktualisht i ka kaluar Ministrisë së Brendshme, duke vërtetuar mungesën e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit të tij, ndërkohë që kjo para publike mund të ishte përdorur në nevoja më të rëndësishme që ka DPD.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Riparimi i skanerit Mobil THSCAN me rreze X*”, komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar ofertën, në kushtet kur kjo ofertë nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, veprime në kundërshtim me kreun V, nenin 53, pika 1, pika 5 germa c të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore janë evidentuar dhe në raportin për Zbatimin e Buxhetit Faktik të vitit 2014 që i është përcjellë Kuvendit në muajin shtator 2015.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 136, datë 30.09.2015, është ngarkuar Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 03.06.2015 deri më 27.07.2015, nga audituesit shtetëror: Edvin Stefani, Agron Opari, Alfred Zylfi, Dorino Meçe dhe Jonild Hoxha, u mbikëqyr nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli, u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, z. Ermal Yzeiraj dhe Drejtori i Përgjithshëm zj. Manjola Naço.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk i është kthyer përgjigje KLSH dhe nuk ka filluar ende zbatimi i rekomandimeve për masat e marra, të cilat i janë dërguar me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015.

Me shkresën nr. 11128/1, datë 7.10.2015, protokolluar me nr. 510/27, datë 12.10.2015, Agjencia e Prokurimit Publik ka vënë në dijeni Kontrollin e Lartë të Shtetit në lidhje me kërkesën drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për dërgim kundërshtimesh në lidhje me procedurat e prokurimit të audituara nga KLSH për të cilat APP do të vijojë me shqyrtimin e konstatimeve në raportin e KLSH.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT